



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

“HASAN PRISHTINA”

UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndërtesa e “Fakultetit Teknik”, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383-38-548 644

URL: <http://www.fna.uni-pr.edu>

Mail: fn@uni-pr.edu

Ref. nr. 5028/1 Prishtinë 16.12. 2022

PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

DEPARTAMENTI KONSTRUKTIV

Studenti Arsim Kodra ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: “ **Projektimi sizmik i strukturave te pa rregullta nga betony i armuar**” në programin e studimeve Master Konstruktiv dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Ndërtimtarisë. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

ABSTRAKT

Punimi i diplomës është marrur me analizën sizmike të një ndërtese shumkatëshe që nuk ka rregullsi strukturore duke u bazuar në standardet Europiane për dimensionimin e strukturave rezistente ndaj temeteve, gjegjësisht në EUROKODIN 8. Ndërtesa e cila i nënshtrohet analizës sizmike është sistem ekuivalent i kombinuar me mure, e cila nuk i plotëson kushtet për ngurtësi ndaj përdhredhjes.

Struktura e llogaritur, konsiderohet si fleksibile ndaj përdhredhjes (Torsionit). Analiza modale e ndërtesës është llogaritur duke përdorur programin ETABS 9.0.

Reagimi sizmik i strukturës është përcaktuar duke përdorur modele të ndryshme matematikore dhe duke marrë parasysh supozime të ndryshme.

Në këtë studim u realizua modeli i mureve si modele lineare por edhe sipërfaqësore dhe ndikimi i gjerësisë së elementeve vertikale pjesëmarrëse në ngurtësinë ndaj akseve kryesore ku vepron temeti.

Dimensionimi i elementeve të konstruksionit është bërë duke u bazuar në rezultatet e dalura nga analiza sizmike, ndërtesa e analizuar nuk ka lartësi shumë të madhe, prandaj klasa e duktilitetit për projektim është marrë DCM – Klasa e mesme e duktilitetit.

Ky punim ka për qëllim që të analizoj përballimin e efekteve të veprimeve sizmike për strukturat të parregullta bazuar në kërkesat e projektimit sipas EC8.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimtarisë.